

Vendim nr. 230, datë 06.07.2026

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahimi, Marjana Semini, Asim Vokshi, anëtarë, në datën 06.07.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 38 (A) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ARBEN GJOLEKA**

OBJEKTI: **Konstatimi i cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor dhe akses efektiv në gjykatë.**
Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2025-3272, datë 25.09.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Konstatimi se komunikimi elektronik i datës 29.10.2025 nuk përmbush standardet kushtetuese të një njoftimi procedural të sigurt dhe efektiv.
Konstatimi i cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.
Rivendosja e së drejtës për ushtrimin efektiv të mjeteve juridike kushtetuese.

BAZA LIGJORE: **Nenet 17, 42, pika 2, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6/1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); neni 71/a i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjo i relatorin e çështjes Asim Vokshi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka blerë një apartament me sipërfaqe 70 m² në Tiranë, të cilin e ka regjistruar në Zyrën Vendore të Pasurive të Paluajtshme Tiranë (*ZVRPP*). Nga akti i kolaudit ka rezultuar se sipërfaqja faktike e tij nuk ishte 70 m², por 84 m². Për këtë shkak ai i është drejtuar Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Veri (*drejtoria vendore e ASHK-së*), së cilës i kanë kaluar kompetencat e ZVRPP-së, duke kërkuar korrigjimin e të dhënave kadastrale për apartamentin në fjalë. Në kushtet e mosmarrjes përgjigje nga ky organ, ai i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së, e cila ka urdhëruar drejtorinë vendore të ASHK-së për marrjen e masave në dhënien e shërbimit të kërkuar. Në vijim të këtij urdhërimi, kjo e fundit ka refuzuar aplikimin e kërkuesit, me arsyetimin se nuk mund të procedonte me korrigjimin e sipërfaqes, pasi kontrata e shitblerjes ishte regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme me sipërfaqe 70 m². Kërkuesi ka paraqitur ankim administrativ, i cili gjithashtu është refuzuar nga Drejtoria e Përgjithshme e ASHK-së.

2. Në datën 31.03.2021 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadi për detyrimin e drejtorisë vendore të ASHK-së: të korrigjojë gabimin material në kontratën e shitblerjes për sa i përket sipërfaqes së apartamentit dhe gabimin në pasqyrimin e të dhënave kadastrale në regjistrin e pasurive të paluajtshme, në kartelë dhe në hartën kadastrale të pasurisë, në raport me dokumentacionin e pronësisë ose me gjendjen faktike të saj në terren; të nxjerrë vendimin (aktin administrativ) për kalimin e pronësisë, privatizimin e pjesës takuese të truallit shtetëror në përdorim për pasurinë; të japë informacion për emrin e subjektit pronar ose bashkëpronar për truallin funksional të pasurisë, si dhe shkakun ligjor të fitimit të pronësisë për këtë truall; të dorëzojë të plotësuar kartelën e pasurisë së paluajtshme, duke shënuar/pasqyruar në të emër, atësi, mbiemër të subjekteve bashkëpronare për këtë pasuri, ekstremitetet e akteve të fitimit të pronësisë nga bashkëpronarët për njësitë ndërtimore të pasurisë,

si dhe emërtimin e këtyre akteve; të kthejë vlerën e tarifës në masën 4.200 lekë, të paguar në mënyrë të padetyruar.

3. Me vendimin nr. 575, datë 24.02.2022, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka pranuar pjesërisht kërkesëpadinë, duke e rrëzuar atë vetëm për kërkimin e detyrimit të drejtorisë vendore të ASHK-së për të korrigjuar gabimin material në kontratën e shitblerjes, për sa i përket sipërfaqes së pasurisë së paluajtshme. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar ankim Avokatura e Shtetit dhe drejtoria vendore e ASHK-së, ndërsa kërkuesi kundërankim. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 04.05.2022 me nr. 31151-01451-86-2022 (nr. akti 16849) dhe nga momenti i regjistrimit e në vijim gjyqtarët relatorë të saj janë ndryshuar disa herë, ndërkohë që nga të dhënat e publikuara në faqen zyrtare të kësaj gjykate nuk rezulton të ketë ende një vendimmarrje për çështjen.

4. Si rrjedhojë e mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, në datën 05.05.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e tejzgjatjes së gjykimit nga Gjykata Administrative e Apelit dhe përshpejtimin e shqyrtimit të saj. Ndërsa ka evidentuar se palët nuk kishin paraqitur asnjë kërkesë për përshpejtimin e çështjes, me vendimin e datës 13.07.2023 Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me argumentin se mosveprimi i Gjykatës Administrative të Apelit nuk kishte ndodhur për shkaqe subjektive që lidheshin me vlerësime ose qëndrime abuzive të gjyqtarit relator ose neglizhencë të tij, por për shkakun objektiv të numrit të lartë të çështjeve.

5. Në datën 03.08.2023 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë dhe konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata Administrative e Apelit.

6. Duke vënë në dukje afatin ligjor 30-ditor të parashikuar nga neni 48 i ligjit nr. 49/2012, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar, për shqyrtimin e çështjeve nga Gjykata Administrative e Apelit, si dhe afatin ligjor 1-vjeçar për përfundimin e gjykimit administrativ në gjykatën e shkallës së dytë, sipas nenit 399/2, pika 1, shkronja “a”, të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), në analizë të kriterëve të vendosura nga jurisprudenca kushtetuese, konkretisht: (i) sjelljes së kërkuetit; (ii) kompleksitetit të çështjes; (iii) sjelljes së autoriteteve; (iv) rëndësisë së asaj çfarë kërkuesi rrezikon, në përfundim të gjykimit të çështjes, me vendimin nr. 21, datë 04.04.2024 (*vendimi nr. 21/2024*), Gjykata ka vendosur rrëzimin e kërkesës.

7. Sipas Gjykatës, sjellja e kërkuessit nuk ishte bërë shkak për tejzgjatjen e gjykimit dhe çështja nuk paraqitej komplekse. Ndërsa ajo ishte në pritje të shqyrtimit prej 1 viti e 11 muajsh, vonesa në gjykimin e saj ishte pasojë e ngarkesës së lartë të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, të shkaktuar nga zbatimi i reformës në drejtësi. Për sa i përket asaj çfarë rrezikonte kërkuessi, Gjykata ka vlerësuar se çështja nuk ishte e tillë që, për shkak të natyrës, të kishte përparësi në radhën e shqyrtimit, dhe në ankimin kushtetues individual kërkuessi nuk kishte provuar se cenimi i së drejtës për të disponuar lirisht pasurinë i kishte sjellë një pasojë të menjëhershme, jetike dhe ngushtësisht personale, të tillë që t’i jepej prioritet gjykimit të çështjes së tij nga Gjykata Administrative e Apelit. Ndaj, pavarësisht se formalisht afatet ligjore nuk ishin respektuar, duke mbajtur në konsideratë ngarkesën e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm në raport me rëndësinë e asaj çfarë kërkuessi rrezikonte, kohëzgjatja e shqyrtimit të çështjes nuk kishte kaluar kufirin kohor të arsyeshëm në aspektin kushtetues.

8. Në datën 14.07.2025 kërkuessi i është drejtuar sërish Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të gjykimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit për periudhën nga data 13.07.2025 e në vijim, si dhe për përshpejtimin e procedurave të gjykimit të saj. Pas marrjes së mendimit të gjyqtarit relator, sipas të cilit, referuar datës kur i kishte kaluar çështja, ngarkesës dhe radhës së gjykimit të çështjeve, afatet ligjore të gjykimit nuk ishin shkelur, me vendimin nr. 00-2025-3272, datë 25.09.2025, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se mosgjykimi i çështjes ka ardhur si rrjedhojë e pamundësisë objektive të gjyqtarit relator, për shkak të ngarkesës, dhe jo për shkak të neglizhencës së tij. Ky vendim i është komunikuar kërkuessit në datën 29.10.2025, në rrugë elektronike.

9. Në datën 12.05.2026 kërkuessi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit, pa vënë në dispozicion kopje të vendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Lartë. Pas plotësimit të kësaj të metë, sipas kërkesave të nenit 27, pika 2, shkronja “e”, të Ligjit Organik të Gjykatës, kërkesa është regjistruar në datën 18.05.2026. Në vijim, në datën 25.06.2026, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve.

II

Pretendimet e kërkuessit

10. **Kërkuessi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar:

Vendim i Mbledhjes së Gjyqtarëve
Kërkuess: Arben Gjoleka

Për legjitimimin ratione temporis

10.1. Komunikimi elektronik i Gjykatës së Lartë i datës 29.10.2025 nuk përmbush standardet kushtetuese të një njoftimi procedural të sigurt dhe efektiv. Ai nuk përmban identifikimin e plotë të gjyqtarëve të trupit gjykues e nënshkrimin e tyre, ose strukturë dokumenti elektronik, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 43/2023 “Për qeverisjen elektronike”, të tilla si: të dhënat e krijimit, vulën elektronike, barkode, elemente autentifikimi procedural, të dhëna të cilësisë dokumentare e nënshkrimin elektronik. KPC-ja dhe Ligji Organik i Gjykatës nuk përmbajnë parashikime që detyrojnë individin të kërkojë kopje të vendimit me elementet që e bëjnë atë të vlefshëm. Neni 316 i KPC-së ia ngarkon gjykatës detyrimin për njoftimin e rregullt të vendimit.

Për themelin e pretendimeve

10.2. Në cenim të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, çështja vijon të jetë në shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit, ndonëse ka kaluar shumë herë afati ligjor 1-vjeçar për përfundimin e gjykimit të saj. Në vendimin për çështjen Gjykata e Lartë nuk ka bërë vlerësim real e konkret të kriterëve të kohëzgjatjes të përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese dhe ajo e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), sipas të cilave mbingarkesa e gjykatave, reformat në sistemin e drejtësisë dhe mungesa e burimeve njerëzore nuk përbëjnë arsye të vlefshme për tejzgjatjen e procedurave gjyqësore.

10.3. Në cenim të së drejtës për mjete juridike efektive, të garantuar nga neni 13 i KEDNJ-së, mekanizmi i krijuar për korrigjimin e tejzgjatjes së gjykimeve nuk ka rezultuar efektiv në rastin e tij. Gjykata e Lartë i ka rrëzuar kërkesën pa kryer një analizë të standardeve kushtetuese, duke e shndërruar mjetin juridik të parashikuar nga nenet 399/1-399/12 në iluzor e joefektiv në praktikë.

10.4. Vendimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar edhe të drejtën për akses efektiv e parimin e sigurisë juridike.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. Për legjitimimin e kërkesës

11. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

12. Mbledhja e Gjyqtarëve vë në dukje se gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes vlerësohet plotësimi i një ose më shumë prej kriterëve të legjitimitetit, në varësi të elementeve ose veçantive të çështjes konkrete, me qëllim që vendimi të jetë sa më i qartë për kërkuuesin. Mospërmbushja edhe vetëm e një kriteri, pa ndjekur një radhë të caktuar të analizës së kriterëve, me pasojë moskalimin e saj në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kriterëve të tjera. Në rastin kur verifikohet dhe arsyetohet mosplotësimi i vetëm një kriteri, kjo vjen si rezultat i zbatimit të karakterit kumulativ të tyre dhe nuk nënkupton se kriteret e tjera paraprake humbasin rëndësinë që kanë për rezultatin e çështjes. Në këtë këndvështrim, në rastin konkret, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon të ndalet në kriterin e legjitimitetit *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës.

13. Në çështjen në shqyrtim, Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se ankimi kushtetues individual ka të bëjë me procesin e dytë të nisur nga kërkuuesi për konstatimin e shkeljes nga Gjykata Administrative e Apelit të afatit të arsyeshëm në gjykimin e mosmarrëveshjes së krijuar si rrjedhojë e refuzimit të drejtorisë vendore të ASHK-së për korrigjimin e gabimit material në kontratën e shitblerjes për sipërfaqen e apartamentit të tij dhe në pasqyrimin e të dhënave kadastrale të pasurisë. Në procesin e parë, pretendimet e tij për konstatimin e kësaj shkeljeje janë rrëzuar fillimisht nga Gjykata e Lartë, me arsyetimin se tejkalimi i afatit të gjyimit ishte rrjedhojë e ngarkesës së gjyqtarit relator (*shih paragrafin 4 të këtij vendimi*). Më pas ato janë rrëzuar edhe nga kjo Gjykatë, me arsyetimin se çështja nuk ishte e tillë që, për shkak të natyrës, të kishte përparësi në radhën e shqyrtimit dhe kërkuuesi nuk kishte provuar se cenimi i së drejtës për të disponuar lirisht pasurinë i kishte sjellë një pasojë të menjëhershme, jetike dhe ngushtësisht

personale (*shih paragrafin 7 të këtij vendimi*). Procesi i dytë është vënë në lëvizje nga kërkuesi për konstatimin nga Gjykata e Lartë të vijueshmërisë së kësaj shkeljeje, kërkesë e cila është rrëzuar sërish nga kjo gjykatë me të njëjtin qëndrim si për kërkesën e parë të tij.

14. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankimin kushtetues individual, objekt shqyrtimi, në datën 12.05.2026, duke kërkuar: i) rivendosjen e së drejtës për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, për shkak të mangësive në njoftimin e vendimit të dytë nr. 00-2025-3272, datë 25.09.2025 të Gjykatës së Lartë, të cilat, sipas tij, i kanë cenuar të drejtën për akses efektiv në Gjykatë; ii) shfuqizimin si antikushtetues të këtij vendimi, që i ka rrëzuar kërkesën për konstatimin e tejzgjatjes së gjykimit dhe përshpejtimit të procedurave të gjykimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit; iii) konstatimin e cenimit nga kjo e fundit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

15. Në funksion të kërimit për rivendosjen në afat të së drejtës për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se kërkuesi ka pranuar se kërkesa nuk është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i Ligjit Organik të Gjykatës. Megjithatë, sipas tij, mosrespektimi i këtij afati nuk ka ardhur si pasojë e neglizhencës së tij, por është shkaktuar nga mangësitë në njoftimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, të cilat kanë ndikuar në ushtrimin në kohë prej tij të së drejtës për t’iu drejtuar Gjykatës. Pikërisht për këtë shkak, krahas kërimit për shfuqizimin e vendimit të kundërshtuar dhe konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, ai ka kërkuar paraprakisht rivendosjen në afat të së drejtës për paraqitjen e ankimit kushtetues individual.

16. Për sa u takon këtyre pretendimeve, Mbledhja e Gjyqtarëve vë në dukje se as Ligji Organik i Gjykatës dhe as Rregullorja e Procedurave Gjyqësore të saj nuk parashikojnë mundësinë e rivendosjes në afat për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, përfshirë këtu edhe rastet kur vonesa në depozitimin e ankimit justifikohet nga arsye objektive ose të jashtëzakonshme. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se rivendosja në afat është një mjet procedural që ka si qëllim garantimin e ushtrimit të së drejtës së ankimit nga palët në proces ndaj një vendimi gjyqësor, në ato raste, të përcaktuara në mënyrë taksative nga ligjvënësi, kur ata nuk kanë pasur mundësi që ta ushtrojnë këtë të drejtë brenda afatit ligjor (*shih vendimin nr. 22 datë 11.04.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Mungesa e një dispozite të tillë në Ligjin Organik të Gjykatës nënkupton se qëllimi i ligjvënësit ka qenë vendosja e një kufiri të prerë kohor procedural për ruajtjen e sigurisë juridike

dhe garantimin e funksionimit efikas të sistemit të drejtësisë kushtetuese, kufi i cili mund të vihet në diskutim vetëm në raste të veçanta.

17. Në rastin konkret, argumentet e kërkuarit për mosparaqitjen në afat të ankimit kushtetues individual parashtrihen në kuadër të mënyrës së njoftimit të vendimit nga Gjykata e Lartë, për të cilën pretendon se nuk është kryer në përputhje me kërkesat procedurale. Në kundërshtim nga sa kërkuari pretendon, Mbledhja e Gjyqtarëve evidenton se vendimi nr. 00-2025-3272, datë 25.09.2025 i Gjykatës së Lartë i është komunikuar kërkuarit në rrugë elektronike në datën 29.10.2025 (fakt ky i pranuar prej tij) në përputhje me rregullat procedurale për njoftimin e akteve gjyqësore sipas nenit 316 të KPC-së, Kreu IV i titullit VI i pjesës I të këtij kodi, të cilat parashikojnë edhe njoftimin elektronik të akteve (*neni 141 i KPC-së*), përfshirë edhe të vendimit gjyqësor, si dhe të urdhrit nr. 131, datë 02.07.2021 të zëvendëskryetarit të Gjykatës së Lartë “Për publikimin e datave të gjykimeve dhe njoftimin e palëve”.

18. Për sa më sipër, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se pretendimi i kërkuarit, se vendimi nuk i është njoftuar në mënyrë të rregullt, nuk përbën argument kushtetues për mosvënien në lëvizje, brenda afatit ligjor 4-mujor, të ankimit kushtetues individual. Ashtu siç është pranuar edhe nga jurisprudenca kushtetuese, në të tilla raste llogaritja e afatit për kundërshtimin e vendimit të Gjykatës së Lartë që ka rrëzuar kërkesën për konstatimin e cenimit të afatit të arsyeshëm të gjykimit dhe përsheptimin e procedurave fillon nga data në të cilën kërkuari ka marrë dijeni efektive për këtë vendim dhe situata vazhduese e shkeljes nuk mund të shërbejë si shkak për shtyrjen për një kohë të pacaktuar të zbatimit të këtij rregulli. Kërkuari ka detyrimin të tregojë kujdesin dhe diligjencën e nevojshme për t’u ankuar në kohën e duhur në këtë Gjykatë për dështimin e vazhdueshëm të gjykatave të zakonshme për të përmbushur detyrimin për shqyrtimin e çështjes së tij brenda një afati të arsyeshëm kohor (*shih vendimin nr. 142, datë 27.06.2023 të Mbledhjes së Gjyqtarëve*). Në këtë këndvështrim, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin se kërkuari është avokat, si dhe se ka qenë në dijeni të detyrimit për respektimin e afatit ligjor, sikurse evidentohet edhe në vendimarrjen nr. 21/2024 të Gjykatës, për pretendime të ngjashme në lidhje me çështjen e tij, Mbledhja e Gjyqtarëve vlerëson se ai, pa shkak të justifikuar, nuk ka ushtruar në afatin e duhur të drejtën për paraqitjen e ankimit kushtetues individual në mbrojtje të të drejtave të tij kushtetuese, që pretendohet se vijnë nga cenimi prej Gjykatës Administrative të Apelit të afateve të gjykimit të çështjeve.

19. Në përmbledhje të sa më lart, në kushtet kur kërkuesi është njoftuar rregullisht nga Gjykata e Lartë për vendimin nr. 00-2025-3272, datë 25.09.2025 të Kolegjit Administrativ të saj, ndërsa nuk ka treguar diligjencën e duhur për kundërshtimin në kohë të tij, Mbledhja e Gjyqtarëve konkludon se ai nuk legjitimohet *ratione temporis*, pasi ankimi kushtetues individual është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor, të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i Ligjit Organik të Gjykatës. Në kushtet e mospërmbushjes së këtij kriteri, vlerësimi i kriterëve të tjera të pranueshmërisë bëhet i panevojshëm, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

20. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin paraprak të ankimit të paraqitur nga kërkuesi Arben Gjoleka, me të cilin ai ka kërkuar konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, ne, gjyqtarët Marsida Xhaferllari, Sandër Beci dhe Marjana Semini, mbajmë një qëndrim të ndryshëm nga shumica. Në vlerësimin tonë, ankimi i përmbushte kriteret paraprake të pranueshmërisë dhe, për rrjedhojë, duhej të ishte vendosur kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

2. Në mënyrë të përmbledhur, çështja kushtetuese ka të bëjë me tejzgjatjen e shqyrtimit gjyqësor të çështjes së kërkuesit nga Gjykata Administrative e Apelit. Mosmarrëveshja në themel lidhet me refuzimin e drejtorisë vendore të ASHK-së për të korrigjuar një gabim material në kontratën e shitblerjes, që kishte të bënte me sipërfaqen e apartamentit të kërkuesit dhe me pasqyrimin e të dhënave kadastrale të pasurisë.

3. Pasi çështja ishte regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 04.05.2022 dhe nuk ishte shqyrtuar brenda afatit njëvjeçar të parashikuar nga neni 399/2, pika 1, shkronja “a”, i KPC-së, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Pas rrëzimit të kësaj kërkesë, në datën 03.08.2023 ai ka paraqitur ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë. Pretendimet e tij lidheshin me periudhën nga data 04.05.2022, kur çështja ishte regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit, deri në datën 05.05.2023, kur ai kishte paraqitur kërkesë në Gjykatën e Lartë. Edhe pse ka konstatuar se çështja vijonte të ishte në shqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit dhe se afati ligjor njëvjeçar ishte tejkaluar, Gjykata, me vendimin nr. 21/2024, e ka rrëzuar kërkesën, me arsyetimin se kërkuesi nuk kishte provuar se vonesa në gjykim i kishte sjellë një pasojë të menjëhershme, jetike dhe ngushtësisht personale, e cila do të justifikonte dhënien e përparësisë në shqyrtimin e çështjes së tij.

4. Meqenëse edhe pas këtij vendimi çështja vijonte të mos shqyrtohej nga Gjykata Administrative e Apelit, kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Pas rrëzimit edhe të kësaj kërkesë, në datën 12.05.2026 ai ka paraqitur ankimin kushtetues individual, objekt i këtij shqyrtimi, duke kundërshtuar vendimin e dytë të Gjykatës së Lartë, me pretendimin se shkelja kishte vijuar dhe nga Gjykata Administrative e Apelit ende nuk ishte dhënë një vendim.

5. Shumica ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se kërkuesi nuk legjitimohet *ratione temporis*. Sipas saj, duke qenë se ai është njoftuar

Vendim i Mbledhjes së Gjyqtarëve
Kërkues: Arben Gjoleka

rregullisht për vendimin nr. 00-2025-3272, datë 25.09.2025 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe nuk ka treguar diligjencën e duhur për ta kundërshtuar atë brenda afatit ligjor, ankimi kushtetues individual është paraqitur jashtë afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i Ligjit Organik të Gjykatës (*shih paragrafin 19 të vendimit*).

6. Në ndryshim nga shumica, ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se, në rastet kur ankimi kushtetues individual ka për objekt një shkelje me karakter vazhdues, afati ligjor 4-mujor i parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i Ligjit Organik të Gjykatës nuk mund të interpretohet nga Gjykata në mënyrë *stricto sensu*. Vetë natyra e një shkeljeje të vazhdueshme nënkupton se cenimi i së drejtës themelore nuk konsumon efektet e tij në një moment të vetëm, por vijon të prodhojë pasoja përgjatë kohës, për sa kohë vazhdon gjendja antikushtetuese. Për rrjedhojë, llogaritja mekanike e afatit të ankimit, duke iu referuar vetëm datës së njoftimit të një vendimi të caktuar, do të ishte e papajtueshme me këtë natyrë shkeljeje dhe do të çonte në kufizimin joproporcional të aksesit në Gjykatë. Një interpretim i tillë do të kishte si pasojë që, megjithëse cenimi vazhdon të ekzistojë dhe të prodhojë efekte ndaj individit, këtij të fundit t'i mohohej mundësia për të kërkuar mbrojtje kushtetuese, duke e bërë kështu mbrojtjen e së drejtës themelore formale dhe iluzive. Për këtë arsye, në raste të tilla, afati i parashikuar nga ligji duhet të interpretohet në mënyrë funksionale dhe në përputhje me natyrën e shkeljes së pretenduar, në mënyrë që të garantohet efektiviteti real i mbrojtjes kushtetuese.

7. Në të njëjtën linjë, GJEDNJ-ja ka pranuar se afati për paraqitjen e kërkesës nuk llogaritet sipas të njëjtave kriterë në rastet kur ankimi ka për objekt një shkelje me karakter vazhdues. Sipas saj, shkelja e dispozitave të KEDNJ-së dhe e protokolleve të saj mund të jetë rrjedhojë ose e një akti të menjëhershëm ose e një situatë vazhduese. Kjo e fundit nënkupton ato situata që burojnë nga veprime ose mosveprime të vazhdueshme të shtetit ose të autoriteteve që veprojnë në emër të tij, për sa kohë që individit vijon të mbetet viktimë e tyre (*shih Meltex LTD kundër Armenisë*, datë 27.05.2008; *Jordache kundër Rumanisë*, datë 14.10.2008, § 50). Për këtë kategori shkeljesh, GJEDNJ-ja ka pranuar se afati për paraqitjen e kërkesës fillon të rrjedhë vetëm në momentin kur situata e pretenduar përfundon (*shih Sabri Güneş kundër Turqisë [DhM]*, datë 29.06.2012, § 54). Për rrjedhojë, për sa kohë situata vazhdon, rregulli i zakonshëm për llogaritjen e afatit nuk gjen zbatim në mënyrë strikte (*shih Bara dhe Kola kundër Shqipërisë*, datë 12.10.2021, § 80; *Jordache kundër Rumanisë*, datë 14.10.2008, §§ 49-50; *Oliari dhe të tjerët kundër Italisë*, datë 21.07.2015, §§ 96-97). Ky interpretim mbështetet në nevojën për të garantuar mbrojtje reale

dhe efektive të të drejtave të Konventës, pasi një qasje formale ndaj afatit të paraqitjes së kërkesës, ndërkohë që shkelja vijon të prodhojë pasoja, do ta bënte ushtrimin e së drejtës së ankimit praktikisht të pamundur dhe, rrjedhimisht, mbrojtjen konvencionale iluzive.

8. Në rastin konkret, edhe shumica ka pranuar se Gjykata Administrative e Apelit ende nuk është shprehur për çështjen e kërkuarit (*shih paragrafin 3 të vendimit*). Për rrjedhojë, kërkuari vijon të presë prej rreth 4 vjetësh e 2 muajsh një vendimmarrje për një mosmarrëveshje që nuk paraqet ndërlikim të veçantë, ndërkohë që afati ligjor 1-vjeçar për shqyrtimin e saj, i parashikuar nga neni 399/2, pika 1, shkronja “a”, i KPC-së, është tejkaluar ndjeshëm. Në thelb, mosmarrëveshja lidhet me refuzimin e autoritetit publik përgjegjës për regjistrimin e pasurive të paluajtshme (ASHK-së) për të korrigjuar një gabim material në kontratën e shitblerjes dhe për ta pasqyruar atë në të dhënat kadastrale të pasurisë, një çështje që, për nga natyra e saj, nuk paraqet kompleksitet të tillë që të justifikojë zgjatjen e procesit për disa vjet. Përkundrazi, zvarritja e gjykimit ka bërë që kërkuari të mbetet për një periudhë të gjatë në pasiguri juridike lidhur me gëzimin e plotë të së drejtës së pronës, ndërsa gjykata vijon të mos japë një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen. Po kështu, nga sjellja procedurale e kërkuarit rezulton se ai ka treguar kujdesin dhe diligjencën e nevojshme për mbrojtjen e të drejtave të tij, duke iu drejtuar në dy raste Gjykatës së Lartë me kërkesa për konstatimin e shkeljes të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm dhe, pas rrëzimit të tyre, edhe kësaj Gjykate me ankime kushtetuese individuale, duke kërkuar njëkohësisht edhe përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes.

9. Në këto rrethana, fakti që ankimi kushtetues individual është paraqitur rreth tre muaj e gjysmë pas përfundimit të afatit ligjor 4-mujor të llogaritur nga data e vendimit të dytë të Gjykatës së Lartë, nuk mund të çojë në humbjen e së drejtës së kërkuarit për t’iu drejtuar Gjykatës. Një përfundim i tillë do të ishte i papajtueshëm me vetë natyrën e shkeljes së pretenduar, e cila vazhdon të prodhojë pasoja për sa kohë Gjykata Administrative e Apelit nuk ka dhënë ende një vendim për çështjen në themel. Pranimi i një interpretimi formal të afatit në një situatë të tillë do të nënkuptonte se, megjithëse shkelja vazhdon, individi do të mbetet i privuar nga çdo mundësi për të kërkuar mbrojtje kushtetuese, duke e bërë kështu të drejtën e ankimit kushtetues individual vetëm teorike dhe iluzive. Ky përfundim është në përputhje edhe me jurisprudencën e GJEDNJ-së, sipas së cilës, për sa kohë situata e vazhdueshme nuk ka marrë fund, rregullat për llogaritjen e afatit nuk mund të zbatohen në mënyrë strikte (*shih Bara dhe Kola kundër Shqipërisë, datë 12.10.2021, § 80*).

10. Ashtu siç ka pranuar edhe Gjykata, normat kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave themelore duhen interpretuar në mënyrë të tillë që ta bëjnë këtë mbrojtje praktike dhe efektive (shih vendimet nr. 53, datë 31.10.2023; nr. 34, datë 17.11.2022; nr. 17, datë 12.11.2004 të Gjykatës Kushtetuese). Në këtë kontekst, një interpretim formalist i afatit ligjor 4-mujor për paraqitjen e ankimit kushtetues individual në rastet e shkeljeve me karakter vazhdues, jo vetëm që e shndërron të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm në një të drejtë teorike dhe iluzore, por cenon edhe miradministrimin e drejtësisë. Kjo, sepse një qasje e tillë nuk i jep zgjidhje përfundimtare pretendimit kushtetues, por e detyron kërkuesin t'i drejtohet vazhdimisht Gjykatës së Lartë me kërkesa të reja për konstatimin e së njëjtës shkelje dhe, pas çdo vendimmarrjeje refuzuese, të paraqesë një ankim të ri kushtetues brenda afatit ligjor. Një cikël i tillë procedural është në kundërshtim me parimin e efektivitetit të mbrojtjes kushtetuese, pasi e zhvendos fokusin nga zgjidhja e shkeljes së pretenduar te respektimi formal i afateve procedurale, duke e bërë mbrojtjen kushtetuese të fragmentarizuar, joefektive dhe rënduese për individin.

11. Për arsyet e mësipërme, ne, gjyqtaret në pakicë, vlerësojmë se ankimi kushtetues individual i paraqitur nga kërkuesi plotëson kriteret paraprake të pranueshmërisë, pasi kërkimi i tij për konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjyqimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata Administrative e Apelit, nuk është haptazi i pabazuar, ndaj kërkesa e tij duhej të kalonte për shqyrtim në seancë plenare.

Anëtarë: **Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Marjana Semini**